



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA OBILIC
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-Izlazna

Nr. 1-100
Br.

Data 18.07.2018
Datum

OBILIQ-OBILIC



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilic - Municipality Assembly Obilic


Në mbështetje të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenit 61 të Statutit të Komunës së Obiliqit, caktoj:

Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa me dt. 26.07.2018, (e enjte) në ora 10:00 në sallën e Kuvendit komunal me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Planit veprues 2018-2021 për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas të Komunës së Obiliqit
4. Shqyrtimi i raportit gjashtë (6) mujor të punës së Kryetarit të Komunës
5. Shqyrtimi i raportit të Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Obiliqit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2017 (Zyra Kombëtare e Auditimit)
6. Shqyrtimi i kërkesës së DMM-së, për vënjen në mbrojtje të monumenteve të natyrës
7. Shqyrtimi i Memorandum Mirëkuptimit të Kryetarit të Komunës dhe katër Komunave tjera, që pasuria natyrore e bjeshkëve të Qyqavicës e cila shtrihet në territorin e pesë (5) komunave të shpallet zonë me interes të përgjithshëm
8. Shqyrtimi i propozimit të DPUKP për shpallje me interes publik, hapësirat e sheshit dhe për rreth tij në zonën e parë të qytetit
9. Të ndryshme

Kryesuesi i Komitetit


Burim Gërguri





Dalës-lizazna

Nr. 1-89
Br.

Data 21.06.2018
Datum

E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.21.06.2018, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm janë këta anëtarë: Florije Jashari, Qëndresa Dubova, Hysni Mjeku, Armend Rushiti dhe Slavisa Spasic

Të pranishmit tjerë: Arben Berisha, drejtor i DPUKP, Merita Emini, udhëheqëse e sektorit të ndërtimit, Nerimane Kelani, udhëheqëse e sektorit të pronës,

Mbledhjen e udhëhoqi Hysni Mjeku, anëtari më i vjetër i Kuvendit komunal, i cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Draft Rregulloreve sipas rekomandimeve të MAPLSë:
 - Rregullorja e punës së Kuvendit të Komunës
 - Rregullorja për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjeba Komunale
4. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) për periudhën 2019 – 2021
5. Të ndryshme

Hysni Mjeku – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës dhe propozoi që në mungesë të materialit pika e tretë e rendit të ditës të hiqet.

Aprovohet njëzërit rendi i ditës, me ndryshimin e cekur më lartë.

1..Pika e parë e rendit të ditës –

Mungoi: Burim Gërguri dhe Linda Sadiku me arsye

2..Pika e dytë e rendit të ditës –

Aprovohet njëzërit ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

3..Pika e tretë e rendit të ditës –

Zarife Behluli - Sa i përket Qarkores buxhetore për vitin 2019-2021, janë të përcaktuara 3 grande: grand i përgjithshëm 2 milion e 782,493 €, grand i Arsimit 2 milion e 671,206 €, dhe grand i shëndetësisë 646,470 €, që në total si grand qeveritar janë 6 milion e 100 mijë e 169 €. Pastaj, kemi huamarrjen në Arsim 9,145 €, huamarrja në shëndetësi 51,718 €, të hyrat vetanake janë 1 milion e 35,562 €, që në total buxheti komunal me grand qeveritar dhe me të hyra vetanake është 7 milion e 196,594 €. Tani, bëhet ndarja në kategoritë ekonomike paga dhe medijtje janë 4 milion e 33,000 €, mallra dhe shërbime 637,205 €, shpenzime komunale 300,000 €, subvencione dhe transfere 200,000 €, investime kapitale 2 milion e 26,389 €.

Tani, drejtoresha jepë sqarime detale për projektet kapitale në bazë të tabelave të paraqitura për të gjitha Drejtoritë komunale. Ne kemi mbajtë debat publik me qytetarë për buxhetin 2019-2021 dhe njoftimi ka qenë publik në portale dhe në faqen zyrtare të Komunës. Ne dijmë se është aprovuar Ligji për Obiliqin dhe Kryetari më autorizoi me ju tregue se ne do të bëjmë kërkesa në Ministrinë e financave në bazë të 20 %, të tantimës që me përfshi në buxhetin për vitin 2019-2021.

Qëndresa Krasniqi – E pyes drejtoreshën çka do të thotë eksproprijimi sepse nuk po e kuptoj.

Hysni Mjeku - Përgjegjet se këtu, fjala është për shpronësim, blerjen e tokave. Unë e pashë se shumica e mjeteve financiare janë dhënë, por nuk janë specifikuar për çka dmth janë dhënë më tepër në total psh në eksproprijim, gjelbërim, për lapidarë, për pllaka përkujtimore dhe ne si anëtarë të KPF-së, absolutisht nuk e dijmë se ku orientohen ato mjete. Mendoj se është dashur dhe ka qenë mirë që këto mjete të specifikohen sepse psh figuron 200,000 €, eksproprijim dhe Qëndresa mirë e bëri pyetjen se edhe unë kam qenë në dilemë se ku shtrihet eksproprijimi nga se ne si anëtarë të KPF-së, nuk jemi në dijeni. Pastaj, te rregullimi i rrugëve, është dhënë totali, por nuk e dijmë e nga orientohen. Ne kemi zona rurale që aspak nuk është investue dhe

tani jemi në prag të KAB-it deri në vitin 2021 dhe ne si anëtarë të KPF-së dhe anëtarë të Kuvendit nuk jemi në dijeni se nga orientohen këto mjete. Poashtu, kemi disa kolona që janë përsëritur shpeshherë nga faja nr.1, e tutje pothuajse gati në çdo faqe është përsëritë 8,000, 8,000, që kishte me qenë mirë të gjitha ato të barten në një total. Për periudhën 2019-2021, nuk kemi as rritje as ndryshim të mjeteve psh huamarrja është 30,000 në disa vende. Pastaj çka nënkupton ngarkesa rregullatore, që unë s'po e kuptoj. Te të hyrat nga qiraja është e njejta shifër deri në vitin 2021, në vend se ne të bëjmë përpjekje me rritë tatimin në pronë, po shkon e kundërta. Pastaj financimet e jashtme 57.000 nuk po e kuptoj sepse financim i jashtëm e kuptoj kur një donator i jashtëm financon në Komunën tonë. Mendoj se Korniza Afatmesme Buxhetore është fleksibile dmth nuk është definitive dhe në bazë të arsyetimit të drejtoreshës, unë jam për aprovimin e kësaj Kornize sepse është një Udhëzues, që vit pas viti mundet me ndryshue.

Zarife Behluli – Sqaron se KAB-i, zakonisht bëhet për vitin vijues dhe bëhet parashikimi edhe për 2 vitet e ardhshme. Unë dua të them asnjë Qarkore buxhetore vit pas viti nuk vjen me vlera të njejta, por gjithmonë ndryshon. Mirëpo, ne jemi të obliguar me dërgue në Ministri të financave, edhe parashikimin për 3 vite. Poashtu, e njejta vlen edhe për 5 kategoritë ekonomike. Te projektet kapitale, ne gjithmonë e kemi praktikë që Ekzekutivi bashkë me Kryetarin e harton buxhetin, bëhen debatet publike me qytetarë, thirren grupet parlamentare dhe diskutojnë rreth buxhetit. Poashtu, kur vjen Qarkorja e dytë buxhetore Ekzekutivi bashkë me grupet parlamentare dhe anëtarët e Kuvendit, një nga një do ti shtjellojnë. Secila Drejtori është e obliguar ta bëjë listën prioritare për investimet ku i caktohet buxheti dhe unë ende nuk i kam ato lista, por janë të obliguar ti përfundojnë deri në buxhetin final për periudhën 2019-2021.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht morën këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit komunal për shqyrtim dhe aprovim Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) për periudhën 2019-2021.

IV.Pika e katërt e rendit të ditës –

Hysni Mjeku – Lexon kërkesën nga Sabit Beqiri, i cili kërkon që pllaka përkujtimore e ngritur në fshatin Breznicë, të zyrtarizohet nga Kuvendi komunal.

Pas diskutimeve, anëtarët e KPF-së, u pajtuan njëzërit që kjo kërkesë ti drejtohet DKRS-së, për shqyrtim.

Hysni Mjeku – Lexon kërkesën nga Burbuqe Baruti, e cila kërkesë ka të bëjë rreth KEDS-it.

Arben Berisha – Ju njoftoj i kemi 3 kërkesa për dhënjen në shfrytëzim të disa lokacioneve për vendosjen e trafove, duke u bazuar në Ligjin për dhënjen në shfrytëzim dhe këmbin të pronës së paluajtshme komunanle. Sipas nenit 9 dhe 10 të këtij ligji bëhet dhënja e pronës së paluajtshme për rastet e veçanta, kur është kërkesa nga Qeveria, nga përfaqësitë diplomatike dhe bashkësitë fetare. Te neni 20, i këtij ligji ceket se dhënja e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim me qëllim të realizimit të investimeve në sektorin e energjisë, bëhet me vendimin e Kuvendit të Komunës, bazuar në legjislacionin e zbatueshëm.

Hysni Mjeku – Kam një kërkesë që shërbimi juaj profesional të na jepë një udhëzim se kërkesa është shqyrtue dhe a ka apo nuk ka mbështetje ligjore për të na lehtësuar neve punën.

Arben Berisha - Ju lus që kërkesën në fjalë ta procedoni në Kuvend, me kusht që ne do t'ua dërgojmë komplet lëndën me sugjerimet tona, bazuar në ligjin në fuqi.

Pas diskutimeve, anëtarët e KPF-së, njëzërit morën këtë:

REKOMANDIM

Që kërkesa e Burbuqe Barutit, për dhënjen në shfrytëzim të disa lokacioneve për vendosjen e trafove të shqyrtohet dhe aprovojat në Kuvend.

Hysni Mjeku – Lexon kërkesën nr.41-27, e dt.30.04.2018, për vendosjen e trafostacioneve në Lajthishtë. Pas diskutimeve, anëtarët e KPF-së, njëzërit morën këtë:

REKOMANDIM

Që kërkesa nr.41-27, e dt.30.04.2018, për vendosjen e trafostacioneve në Lajthishtë, të shqyrtohet dhe aprovojat në Kuvend.

Hysni Mjeku – Lexon kërkesën nga Fanol Shala, klubi aeronautik i cili kërkon një lokal për zhvillimin e disa aktiviteteve sportive.


Pas diskutimeve, kjo kërkesë i drejtohet DKRS-së, për shqyrtim.

Hysni Mjeku – Lexon kërkesën nga Fahredin Sadiku, nga Sibofci i cili kërkon që në lokalet e Bashkësisë lokale në Sibofc, të lejohet që profesoresha e gjuhës angleze Verona Sylejmani, ti mbanë orët e kurseve të gjuhës angleze.

Pas diskutimeve, kjo kërkesë i drejtohet DKA-së, për shqyrtim.

Mbledhja përfundoi në ora 10:40'

Bashk.prof.për punë të KK-së


Azize Zeneli

Udhëheqësi i mbledhjes


Hysni Mjeku

